



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 158, datë 15.05.2020

PËR MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR GJYQTARIN E GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT TIRANË Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në nenin 64, 65, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në datë 30.06.2020, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit.
2. Të përjashtojë gjyqtarin z.{...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

